



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRI

Nr. 3614/prot.
110

Tiranë, më 21/12/2021

URDHËR
Nr. 373/4, datë 21.12.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 99, DATË 10.02.2021

“PËR KUFIZIMIN E LËVIZJES BRENDA VENDIT” TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 4, gërmat “d” të Ligjit Nr.15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, sipas udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, në zbatim të Vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirus i ri Nr. 4881 datë 02.12.2021, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

Në Urdhrin Nr. 99, datë 10.02.2021 “Për kufizimin e lëvizjes brenda vendit” të ndryshuar, bëhet ndryshimi si vijon:

1. Në pikën 1 të Urdhrit, togfjalëshi “deri në datë 21.12.2021” zëvendësohet me togfjalëshin “deri në datë 04.01.2022”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.


MINISTRI
Ogerta Manastirliu

